


E DREJTA PËR INFORMIM

Forcimi i transparencës proaktive, rritje e kapaciteteve profesionale dhe përditësim i instrumenteve



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është gjithnjë e angazhuar në rritjen e kapaciteteve profesionale në funksion të forcimit të transparencës proaktive të institucioneve shqiptare.

Me këtë synim, gjatë ditëve të fundit të vitit 2024, u zhvilluan një seri trajnimesh online me koordinatorët për të drejtën e informimit dhe personat e kontaktit për të dhënat e hapura nga të gjitha autoritetet

publike qendrore dhe të strukturave të varësisë, të organeve të vetëqeverisjes vendore, institucioneve të pavarura, atyre të sistemit të drejtësisë (gjykata dhe prokurori), të shoqërive/kompanive me kapital publik, etj. Trajnimet u fokusuan në tre elemente kryesore: përmbushjen e detyrimeve të legjislacionit lidhur me aksesin në informacionin publik dhe publikimin/përditësimin e Regjistrimit të Kërkesave dhe Përgjigjeve; Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve nëpërmjet portalit pyetshtetin.al, instalimi/përditësimi i tij në autoritete publike të reja apo ku ka patur ndryshim të koordinatorit, si dhe mbi përmbushjen e detyrimeve të legjislacionit lidhur me të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit publik. Stafi i Zyrës së Komisionerit bashkëveproi me të pranishmit për të adresuar problematika nga më të ndryshmet në lidhje me përditësimin e vazhdueshëm të tyre, duke ofruar shembuj sipas praktikave më të mira vendase dhe të huaja. Nëpërmjet këtyre instrumenteve/mekanismave çdo autoritet publik përveçse forcon akoma më tej transparencën proaktive, ndikon, po ashtu edhe në përmirësimin e shërbimeve që u ofron qytetarëve apo grupeve të interesit.

PËRMBLEDHJE MUJORE E VENDIMEVE

Vendim Nr. 32 - [Bordi i Mbikëqyrjes Publike](#)

Vendim Nr. 33 - [Bordi i Mbikëqyrjes Publike](#)

Vendim Nr. 34 - [Bordi i Mbikëqyrjes Publike](#)

Vendim Nr. 37 - [Korporata Elektroenergjitike
e Shqipërisë Sh. A](#)

Vendim Nr. 44 - [Bashkia Tiranë](#)


PËRMBLEDHJE MUJORE E REKOMANDIMEVE

Rekomandim Nr. 34 - [Agjencia e Menaxhimit të
Garancive dhe Kredive të Pakthyer](#)



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit dhjetor 2024



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit nëntor 2024, ka dhënë 5 vendime në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.

Me vendimin nr. 37, datë 06.12.2024, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj "KESH Sh. A." (në vijim Autoriteti Publik"), me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet kërkesës, depozituar Autoritetit Publik, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion dokumentacioni, në lidhje me "Pasqyrat Financiare për vitet ushtrimore 2021, 2022 dhe 2023. dhe "Raportet e auditimit të bilanceve për vitin 2018, 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023".

Autoriteti Publik i ka kthyer përgjigje ankuesit duke e sqaruar se: "...pasqyrat financiare për vitet ushtrimore 2021, 2022 dhe 2023 janë në proces auditimi nga auditorët dhe sapo të certifikohen, informacioni do t'ju vendoset në dispozicion..." .

Ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka depozituar ankesën duke sqaruar se: "...KESH, në vitin 2022 më ka vendosur në dispozicion bilancin financiar të vitit 2021..." .

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të LDI, ka kërkuar të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar duke ftuar palët në një seancë dëgjimore. Seanca u zhvillua me prezencën e ankuesit dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik. Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë. Ndërkohë, përfaqësuesit e Autoritetit Publik, i qëndruan pretendimit se: "...KESH SH.A. ka kontraktuar auditues ligjor, por ende nuk ka marrë shërbimin e kërkuar. Me përfundimin e auditimit ligjor të vitit 2021, i hapet rruga për auditimin e viteve pas ardhës. Në konkluzion të sa më sipër dhe në përgjigje të kërkesës së ankuesit, KESH SH.A., ka të publikuar pasqyrat financiare të vitit 2018, 2019, 2020. Sa i përket termit "bilanc", nuk e gjejmë të pasqyruar në asnjë akt ligjor...", pretendime të depozituara nëpërmjet postës elektronike.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, qëndrimin të mbajtur nga Autoriteti Publik në seancën dëgjimore dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik për ankesën e paraqitur, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI. Bazuar në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 2 të LDI, KESH Sh. A., është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës. Për të munduruar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI. Konstatohet se, Autoriteti Publik nuk ka argumentuar lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar bazuar në kufizimet që parashikon neni 17 i LDI, si dhe nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë apo të argumentojë se si kjo e drejtë kufizohet, kur është e domosdoshme, proporcionale, në mënyrë të tillë që të bënte dhe vlerësimin e interesit publik më të lartë. Në çdo rast, duke qenë se informacioni i kërkuar lidhet me fushën e energjisë, interesi publik për të aksesuar informacion/dokumentacion lidhur me prodhimin, importimin, shitjen, blerjen dhe akumulimin, në këtë rast është i drejtëpërdrejtë dhe tejet i lartë. Referuar pretendimit të Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se ky pretendim nuk qëndron.

Autoriteti Publik nuk paraqiti prova për të mbështetur argumentat e paraqitura, pasi vetë Autoritetit Publik, në seancë dëgjimore, deklaroi se, gjatë viteve të kaluara pasqyrat financiare

janë depozituar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Pohimi i mësipërm bie ndesh me pretendimet e depozituara, në të cilat Autoriteti Publik, ngre pretendimin se, nëse pasqyrat financiare nuk certifikohen nga audituesit e jashtëm të kontraktuar nga kompania, këto pasqyra financiare nuk janë të sakta, të përdorshme dhe të publikueshme. Në pikën 2, të nenit 2, të LDI parashikohet se: "informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik".

Në kuptim të nenit të sipërcituar, pasqyrat financiare të cilat Autoriteti Publik i ka depozituar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, do të konsiderohen si dokumentacion, i prodhuar dhe i depozituar në zbatim të ligjit nr. 9920, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe akteve ligjore të dala në zbatim të tij. Autoriteti Publik duhet të kishte vënë në dispozicion të kërkuarit, në formën që i dispononte, dokumentacionin e kërkuar, duke mbajtur në konsideratë parashikimet e nenit 17 të LDI. Për sa më sipër, Autoriteti Publik, duke vlerësuar dhe hierarkinë e akteve ligjore, nuk mund të refuzonte dokumentacionin, me arsyetimin e sipërcituar, por duhet t'i vendoste ato në dispozicion të kërkuarit duke specifikuar faktin se, këto pasqyra financiare, nuk do të ishin definitive dhe se mund të kishte ndryshime në to, pas auditimit dhe certifikimit nga shoqëria e ngarkuar. Refuzimi në total i pasqyrave financiare, të depozituara nga Autoriteti Publik, pranë D.P.T., me arsyetimin e dhënë nga Autoriteti Publik, vjen në kundërshtim me parashikimet e LDI.

Qëndrimi i mësipërm, njëkohësisht evidenton Drejtorin e Departamentit Ekonomik si person përgjegjës për trajtimin e kërkesës, në shkelje të dispozitave të parashikuara nga neni 15 dhe 17 të ligjit të LDI, pasi konsiderohet si refuzim i dhënies së dokumentacionit të kërkuar, pa e arsyetuar dhe mbështetur në parashikimet e nenit 17 të LDI. Komisioneri vlerësoi se, dokumentacioni i kërkuar, në parim përbën informacion publik bazuar në pikën 2, të nenit 2, të LDI. Rrjedhimisht, ekzistenca e dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse është prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të këtij ligji. Për sa i përket pikës së dytë të kërkesës për informacion: "Raportet e auditimit të bilanceve për vitet.", autoriteti publik deklaroi gjatë hetimit administrativ se: "...dokumentacioni i kërkuar nuk është prodhuar ende pasi shoqëria e kontraktuar për auditimin e jashtëm, është ende duke audituar bilancet financiare, dhe si pasojë nuk ka dorëzuar ende asnjë dokumentacion lidhur me auditimin dhe certifikimin e këtyre pasqyrave financiare, si rrjedhojë nuk mund ta vendosim në dispozicion pasi nuk e disponojmë dokumentacionin e kërkuar...", Komisioneri vlerëson, bazuar në pikën 2 të nenit 2 të LDI, se ankesa duhet të rrëzohet për këtë pikë, pasi dokumentacioni i kërkuar ende nuk është prodhuar dhe nuk disponohet nga Autoriteti Publik.

Në përfundim Komisioneri vendosi, pranimin pjesërisht të ankesës, urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion, konkretisht për pikën e parë: "Pasqyrat Financiare për vitet ushtrimore dhe për pikën e dytë: "Raportet e auditimit të bilanceve.", duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI, rrëzimin e ankesës për pikën e dytë: "Raportet e auditimit të bilanceve për vitet e kërkuara", dënimin e Drejtorit të Departamentit Ekonomik, në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me pikën 4 të nenit 19 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.

“Mësuam nga e tashmja, sollëm të renë” – 2025, ligji i ri “Për mbrojtjen e të dhënave personale”



Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale zhvilloi një pritje në kuadër të miratimit të ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale, i cili parashikohet të hyjë në fuqi në vitin 2025.

Në këtë takim morën pjesë Ministri i Drejtësisë, z. Ulsi Manja; Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni; Kryetari i Komisionit për Sigurinë Kombëtare të Kuvendit të Republikës së

Shqipërisë, z. Nasip Naço; Avokatja e Popullit, znj. Erinda Balanca; Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, z. Robert Gajda, përfaqësues nga Kuvendi, Ministria e Drejtësisë, ekspertë dhe bashkëpunëtorë.

Në fjalën e mbajtur në këtë ceremoni, Komisioneri Besnik Dervishi theksoi se: “Sot, me ligjin e ri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, vendi ynë ka siguruar standardet më të larta, të përcaktuara edhe në Rregulloren e Përgjithshme të BE për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, GDPR.”

Z. Dervishi falenderoi të gjithë aktorët e përfshirë në procesin që zgjati 4 vite, deri në finalizimin e tij, me miratimin e ligjit të ri, të përafruar plotësisht me kuadrin rregullator të BE.

Ky ligj sjell risi që ecin paralelisht me zhvillimet teknologjike dhe digjitalizimin e shërbimeve, si: mënyra të reja të dhënies së pëlqimit; e drejta për t’u harruar; konceptet inovative, si transferueshmëria e të dhënave; privatësia në projektim dhe në mënyrë të paracaktuar; si dhe parashikon sanksione më të forta për shkeljet e dispozitave të tij. Përafrimi i kuadrit rregullator kombëtar me atë të BE, konsolidon dhe funksionet e Zyrës së Komisionerit për t’iu përgjigjur më mirë sfidave e problematikave të cenimit të privatësisë dhe mbrojtjen e duhur të të dhënave personale.



Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:



Komisioneri KDIMDP



IDP Albania



idp.albania



IDP Albania